



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 01/142
Datë: 19.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 19 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet; 137 dhe 138 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 02/142
Datë: 19.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 19 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Bashkëpunim dhe Ndihmë të Ndërsjellë në Raste të Fatkeqësive Natyrore dhe Fatkeqësive Tjera, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme që t'i zhvillojë negociatat me Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, më qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/142
Datë: 19.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 20 të Ligjit nr. 04/L-176 për Turizmin, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 19 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli i Turizmit të Kosovës, në këtë përbërje:
 - 1.1. Valbone Dushi - kryesuese, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
 - 1.2. Sami Sinani - anëtar, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
 - 1.3. Ryve Prekorogja - anëtare, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
 - 1.4. Drenushe Behluli - Mehmeti, anëtare, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
 - 1.5. Virtyt Morina - anëtar, përfaqësues i Asociacionit të Komunave;
 - 1.6. Hajrulla Çeku - anëtar, OJQ "Ec ma ndryshe";
 - 1.7. Sali Shoshi - anëtar, ekspert i turizmit.
2. Anëtarë vëzhgues janë:
 - 2.1. Miloš Đukić, përfaqësues i Komunës së Shtërpcës;
 - 2.2. Haxhi Seferqaj, përfaqësues i Komunës së Prizrenit.
3. Këshilli detyrat e tij i kryen në përputhje me nenin 20 të Ligjit Nr. 04/L-176 për Turizmin.
4. Sipas nevojës dhe rrethanave, Këshilli mund të kërkojë informata shtesë dhe ekspertizë prej Institucioneve relevante të Republikës së Kosovës.
5. Ngarkohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për sigurimin e hapësirës dhe mbështetjes teknike për Këshillin me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë së tij.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 04/142
Datë: 19.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. prot. 3300/4/2016, të datës 30.03.2017, në mbledhjen e mbajtur më 19 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi dhe krijimi i detyrueshëm i servitutit për interes publik të pronave private dhe shoqërore të cilat preken nga realizimi i Fazës së Tretë të Projektit për ndërtimin e "Fabrikës së Re të Ujit në fshatin Shkabaj", Zonat Kadastrale Shkabaj dhe Prishtinë, Komuna Prishtinë dhe Zonat Kadastrale Obiliq, Mazgit dhe Llazarevë, Komuna Obiliq, sipas tabelave pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interes, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" nr. protokollit 662/17 datë 08.02.2017.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara sipas pikës 1. të këtij vendimi.
4. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar apo zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë në gjykatën kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.

6. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe 1 (një) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Ndërmarrja Publike Qendrore "Kompania Ujësjiellësi Rajonal (KUR) Prishtina - Sh.A" do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastralë në emër të titullarëve të rinj, si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryejë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 05/142
Datë: 19.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 44 të Ligjit nr. 04/L-193 për Avokatinë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë me nr. prot. 814, të datës 24.03.2017, në mbledhjen e mbajtur më 19 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndalohet ekzekutimi i Rregullores për caktimin e avokatëve sipas detyrës zyrtare dhe ofrimin e ndihmës juridike falas, deri në vendimin përfundimtar të gjykatës.
2. Obligohet Oda e Avokatëve të Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/142
Datë: 19.04.2017


Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 19 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Zyrës së Kryeministrit - Ministres pa Portofol 1, për transferin e stafit prej 50 (pesëdhjetë) zyrtarëve, si dhe mjeteve financiare në shumë prej **31.643** (tridhjetenjëmijegjashtëqindedyzetetë) euro, nga Fondi i Kontingjentit i paraparë në aneksin e vendimit nr. 06/39 të Qeverisë, i datës 22.07.2015 për zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit për shpërbërjen e të ashtuquajturës "Mbrojtja civile" dhe integrimin e ish-personelit të saj në institucionet civile të Republikës së Kosovës.
2. Mjetet financiare dhe stafi i paraparë nga pika 1. e këtij vendimi merren nga Ministria e Financave, me kod 201, nën programi Kontingjenca në paga për marrëveshjen e Brukselit, me kod 28700, kategoria ekonomike paga e mëditje dhe transferohen në organizatat buxhetore, si vijon:
 - 2.1. Ministria e Punëve të Brendshme, me kod 214, i shtohet stafi prej 2 zyrtarëve në nën programin Agjencia për Menaxhimin Emergjent, me kod 32700;
 - 2.2. Ministria e Drejtësisë, me kod 215, i shtohet stafi prej 2 zyrtarëve në nën programin Shërbimi Korrektues i Kosovës, me kod 33600;
 - 2.3. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me kod 209, i shtohet stafi prej 5 zyrtarëve në këto nën programe:
 - 2.3.1. Divizioni për Punësim, me kod 43100, i shtohet stafi prej 2 zyrtarëve;
 - 2.3.2. Pensionet bazike me kod 00100, i shtohet stafi prej 2 zyrtarëve;
 - 2.3.3. Trajnimi profesional, me kod 91200, i shtohet stafi prej 1 zyrtari.
 - 2.4. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me kod 203, i shtohet stafi prej 6 zyrtarëve si dhe masa monetare prej 11,358 euro në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje në këto nën programe:
 - 2.4.1. Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike, me kod 40400, i shtohet stafi prej 4 zyrtarëve, si dhe masa monetare prej 7,572 euro në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje;

- 2.4.2. Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me kod 47400, i shtohet stafi prej 2 zyrtarëve, si dhe masa monetare prej 3,786 euro në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje.
- 2.5. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me kod 207, i shtohet stafi prej 2 zyrtarëve, si dhe masa monetare prej 4,377 euro në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje në nën programi Arritjet Sportive me kod 80200;
- 2.6. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me kod, 208 i shtohet stafi prej 2 zyrtarëve në nën programin Administrata Qendrore me kod 11308;
- 2.7. Ministria për Komunitet dhe Kthim, me kod 211, i shtohet stafi prej 6 zyrtarëve si dhe masat monetare prej 4,550 euro në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje në nën programin Administrata Qendrore me kod 11311;
- 2.8. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, me kod 204, i shtohet stafi prej 2 zyrtarëve në këto nën programe:
- 2.8.1. - 1 zyrtar në nën programin Agjencia për Zhvillim dhe Promovim të Sektorit Privat me kod 49000;
- 2.8.2. - 1 zyrtar në nën programin Departamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës me kod 49100;
- 2.9. Ministria e Infrastrukturës, me kod 205, i shtohet stafi prej 2 zyrtarëve në këto nën programe:
- 2.9.1. - 1 zyrtar në nën programin Departamenti i Inspektoratit, me kod 42800;
- 2.9.2. - 1 zyrtar në nën programin Departamenti i Automjeteve, me kod 42400;
- 2.10. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me kod 210, i shtohet stafi prej 2 zyrtarëve në nën programin e Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit, me kod 43600;
- 2.11. Ministria e Financave, me kod 201 i shtohet stafi prej 2 zyrtarëve, në nën programin Administrata Tatimore, me kod 11600;
- 2.12. Ministria e Administratës Publike, me kod 202, i shtohet stafi prej 4 zyrtarësh dhe masa monetare prej 7,572 euro në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje, në këto nën programe:
- 2.12.1. - 2 zyrtarë në nën programin Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, me kod 12600 si dhe masa monetare prej 3,786 euro në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje;
- 2.12.2. - 2 zyrtarë në nën programin Departamenti i Standardeve dhe Politikave të IMNQ-ës, me kod 12300, si dhe masa monetare prej 3,786 euro në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje.
- 2.13. Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, me kod 212 i shtohet stafi prej 9 zyrtarëve në nën programin Administrata Qendrore me kod 11312;
- 2.14. Ministria e Zhvillimit Ekonomik me kod 213 i shtohet stafi prej 2 zyrtarëve dhe masa monetare prej 3,786 euro në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje në nën programin Uji dhe Hedhurina me kod 22500;

- 2.15. Ministria e Shëndetësisë, me kod 206, i shtohet stafi prej 2 zyrtarëve në nën programin Sistemi i Informimin Shëndetësor, me kod 72100.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Institucionet tjera të ndikuara për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 07/142
Datë: 19.03.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 19 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për tërheqjen e Projektligjit për Arsimin e Lartë nga procedurat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin për tërheqjen e Projektligjit nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 08/142
Datë: 19.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. protokoll 868 datë 30.03.2017, në mbledhjen e mbajtur më 19 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Informata e prezantuar nga Ministria e Integrimit Evropian për Takimin e Nën Komitetit të MSA-së për Tregti, Industri, Dogana dhe Tatime, ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë